



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1131/4 prot

Datë 30.04.2026

V E N D I M
Nr. 574/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar –”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka S.H.A, Nr.8240, Njësia Nr.6., Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë. Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar –”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 20.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6347 dhe me nr. 535 prot., datë 20.02.2026 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me anë të së cilës ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 851/3 prot., datë 02.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 535/1 pr., datë 05.03.2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik kthimi i përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, dhe në përfundim ka vendosur mos pranimin e ankesës.

II.5. Me vendimin nr. 400/2026, datë 17.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

[...]

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.*
2. *Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [...]

II.6. Me shkresën nr. 1228/1 prot., datë 27.03.2026 me objekt “Njoftim për zbatimin e Vendimit nr.400/2026, Nr.535/5 prot të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën nr. 535/7 prot., datë 30.03.2026, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë njofton se ka zbatuar vendimin Nr.400/2026, datë 17.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke publikuar në SPE edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit më datë 28.03.2026.

II.7. Me vendimin nr. 453/2026, datë 01.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

[.....]

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [.....]

II.8. Në datën 12.04.2026, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankimi elektronik A/2026/6520, protokolluar me nr. 1131/2026 prot., datë 14.04.2026 i operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, duke kundërshtuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi.

II.9. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 1556/3 prot., datë 24.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1131/1 prot., datë 29.04.2026 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit duke kundërshtuar kriterin 2.2.3 i cili është modifikuar dhe publikuar nëpërmjet shtojcës së datës 28.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 16.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar –”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë..

III.1.2. Më datë 28.03.2026 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.400/2026, datë 17.03.2026, ka publikuar në SPE shtojcën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi

III.1.3 Më datë 07.04.2026 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, ka publikuar në SPE shtojcën për ndryshim të afateve për procedurën e prokurimit të sipërcituar në zbatim të vendimit nr.453/2026, datë 01.04.2026 të KPP i cili ka vendosur lejimin e autoritetit kontraktor me vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

III.1.4. Në datën 12.04.2026, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankimi elektronik A/2026/6520, protokolluar me nr. 1131/2026 prot., datë 14.04.2026 i operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, duke kundërshtuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi.

III.1.5. Nëpërmjet shkresës nr. 1556/3 prot., datë 24.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1131/1 prot., datë 29.04.2026 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III.1.6. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.

III.1.7. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.8. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimin” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.9. Në nenin 111, pika 1 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.

Neni 115, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.10. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret referuar verifikimeve në sistemin e

prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 28.03.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi. Më datë 07.04.2026 Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin për ndryshimin e dokumentave të tenderit nga ku rezulton se nuk ka ndryshime të dokumentave por vetëm ndryshim të afateve të zhvillimit të procedurës së prokurimit. Më datë 12.04.2026 operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë KPP dhe autoritetit kontraktor lidhur me shtojcën për modifikimin e dokumentave për procedurën në fjalë. Referuar dokumentave të dosjes rezulton se ankesa e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK lidhet me modifikimin e kriterit 2.2.3.e cila është publikuar më datë 28.03.2026. Nga sa më sipër rezulton se ankimuesi është njohur me shtojcën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi në datën e publikimit të saj datë 28.03.2026. Në këtë kuptim, KPP gjykon se afatet e ankimimit për shtojcën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi për ankimuesin, nisin në datën 29.03.2026 dhe mbarojnë në ditën e dhjetë sipas parashikimit ligjor në nenin 110, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Ndërkohë KPP gjykon se ankesa e operatorit ekonomik ankimues e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së më datë 12.04.2026 është jashtë afateve ligjore të ankimimit pasi referuar sa më sipër afatet e ankimimit do të llogariten nga data e publikimit të shtojcës dhe jo nga shtojca për njoftim mbi ndryshimin e afateve të hapjes së ofertave.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon ankesa është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110 pika 1 e LPP i cili parashikon se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret data e publikimit të shtojcës për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është 28.03.2026, ndërkohë ankesa e paraqitur nga ankimuesi pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së është data 12.04.2026, pra është jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar kështu *ratione temporis*. Ndërsa më datë 07.04.2026 është publikuar shtojca për ndryshim të afateve të hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritet kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Gjithashtu lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit duke kundërshtuar kriterin 2.2.3 i cili është modifikuar dhe publikuar nëpërmjet shtojcës së datës 28.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në nenin 110, pika 1, 2, 3, 7 dhe 8 të ligjit nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit të ofertave, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni.

4. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

5. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.2.2. Në nenin 121, pika 1 të ligjit nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik palët e interesuara kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, sipas afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”.

III.2.3. Nga interpretimi në tërësi i dispozitës së sipërcituar del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar çdo lloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor, i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi në tërësi i ankesës të paraqitur nga ankimuesi konstatohet, se ky i fundit kundërshton shtojcën (Për ndryshimin e dokumentave të tenderit) të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 400/2026, datë 17.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se operatorët ekonomikë ankimues mund të kundërshtojnë

vendimet e tij vetëm pranë Gjykatës Administrative të Apelit sikundër citohet dhe në nenin 121 pikën 1 të dispozitivit të çdo vendimi që merr Komisioni.

III.2.4. Komisioni gjykon se në rastin konkret pretendimet e parashtruara në ankesë përbëjnë “res judicata” (gjë të gjykuar), për të cilat Komisioni është shprehur në vendimin KPP nr. 400/2026, datë 17.03.2026, mbi bazën e ankesës së operatorit ekonomik ankimues për procedurën në fjalë, vendim i cili në bazë të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar përkatësisht nenit 30 pika 2, është administrativisht përfundimtar. Në këtë kuptim, kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo, analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar dhe për rrjedhim, ipso lege, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim. Vlen të ritheksojmë se në kuptim të ligjit nr. 162/20200 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve publike, i cili, shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, dhe merr vendime të cilat janë administrativisht përfundimtare.

III.2.5. Komisioni thekson faktin se fuqia e “res judicata” (gjësë së gjykuar) mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit administrativ përfundimtar, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në shqyrtim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese, dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron organi administrativ në dispozitivin e vendimit të tij. Në doktrinën juridike dhe për analogji edhe të organeve më të larta gjyqësore si edhe të Gjykatës Kushtetuese, parimi i gjësë së gjykuar (res judicata), pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Në vijimësi, ligjvënësi ka parashikuar qartësisht, se vendimet e dhëna nga Komisioni i Prokurimit Publik janë administrativisht përfundimtare, e cila është shprehje dhe konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenim të vetë sigurisë juridike. Në jurisiprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Autoriteti kontraktor në publikimin e shtojcës nr .2 të DST (Për ndryshimin e dokumentave të tenderit) ka zbatuar Vendimin nr. 400/2026, datë 17.03.2026, ku pasi është shqyrtuar nga KPP-ja, ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK ka vendosur pranimin pjesërisht të saj. Mbi bazën e këtij vendimi autoriteti kontraktor ka kryer modifikimin e dokumentave të tenderit dhe mbasi kjo shtojcë për modifikim është publikuar në SPE Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin e saj ka lejuar autoritetin të vijojë me hapat e mëtejshëm me vendimin nr.453/2026, datë 07.04.2026. Në këtë kuptim, Komisioni nuk gjendet përballë asnjë rrethane të re për të cilën nuk ka qenë në dijeni në kohën e marrjes së vendimit përfundimtar, që të mund të legjitimojë ankimuesin në pretendimet e tij lidhur me publikimin e shtojcës (Për ndryshimin e dokumentave të tenderit). Rrjedhimisht, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet për paraqitjen e ankesës në Komisionin e Prokurimit Publik e rrjedhimisht pretendimet e tij nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2024, datë 13.10.2024 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar –”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

